

-34

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

V E N D I M

Nr. 4 Date 17.03.2011

“PER
MIRATIMIN E LEJES
PER PERDORIM TE REZERVES UJORE
PER PRODHIM HIDROENERGJIE.

Bazuar ne ligjin nr. 8093 dt. 21.06.1996 “Per rezervat ujore”, neni 18 germa dh, dhe te vendimit nr. 87 dt. 16.01.2008 te K.M., “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M.”Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, ne Kreun XI, piken 9,”Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates”,si dhe te V.K.M. nr. 708 dt. 21.05.2008, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

V E N D O S I :

- 1- MIRATIMIN e Lejes per Perdorim te Rezerves Ujore, Lumi “Dardhe”, Rrethi Puke, per kaskaden e hidrocentraleve ne lumin Dardhe, shoqerise Koncesionare “Compagnie Nationale du Rhone”, “WEnerg”, per prodhim hidroenergjie, nga kuota + 1045 m deri ne kuoten + 300 m., sasia e ujit qe do perdore eshte $Q=1\text{ m}^3/\text{sek.}$, e cila ka nenshkruar Kontraten e Koncesionit te formes “BOT” me date 18.08.2009.
- 2- Leja e perdorimit te rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- 3- Tarifa per leshimin e lejes do te behet sipas pikes 3 te vendimit nr. 13 dt. 09.08.2006 te K.B.U. Drin-Bune.
- 4- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

Sekretari

Muhamet MUÇA

Kryetari

Maxhid CUNGU